



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 580/6 prot.

Datë 05.03.2026

V E N D I M

Nr. 351 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.03.2026 me:

Objekt: Mbylljen e çështjes për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” ShPK për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë ANBIM ShPK dhe BESIM KAMBERI P.F. në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-74201-01-20-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi, detergjent” me fond limit 5.083.320 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” ShPK me NIPT K91624505A, Adresa: Fshati Ahemtaq, pranë firmës Ital Kon, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë.
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu” Vlorë.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “ANBIM SHPK” ShPK, me Nipt L81618008J, Adresa: Autostrada TR-DR Km1 Z. Kadastrale 2679 Nr. pasurie 40/55, Tiranë.

Operatori ekonomik “BESIM KAMBERI P.F, me Nipt L42103023G, Adresa: Rr. e Qelqit , Z. Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 – Kashar, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, informacionin e autoritetit kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 21.01.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-74201-01-20-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi, detergjent” me fond limit 5.083.320 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, dhe në datën 17.02.2026 ka njoftuar operatorët ekonomikë

pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

1. ANBIM Shpk	me vlerë	2,748,768 L. pa TVSh	Kualifikuar
2. BESIM KAMBERI PF	“	2,903,085	“
3. EURO MEGA 2010 Shpk,	“	3,100,375	“
4. MURATI D Shpk.	“	3,182,218	“
5. Biotek Shpk	“	3,237,698	“
6. ATLANTIK 3 Shpk	“	3,598,910	“
7. KEJ Group Shpk	“	3,900,060	“
8. ERVIN LUZI PF	“	4,700,000	“
9. Albania Distribution Chemicals shpk	“	5,020,000	“
10. I & V Company Shpk	“	0	“

II.3. Më datë 18.02.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin fituesi paraparak të procedurës.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6360, datë 24.02.2026 dhe me Nr. 580/2026 Prot., date 24.02.2026, nga operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” ShPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*” Mallra, me Nr. REF-74201-01-20-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi, detergjent” me fond limit 5.083.320 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorëve ANBIM ShPK dhe BESIM KAMBERI P.F, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.5. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe Formular për Publikim me Nr. 580/1 prot., datë 25.02.2026.

II.6. Autoriteti Kontraktor ka përcjellë në sistem shkresën me nr.4164 Prot., datë 27.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 580/2, datë 02.03.2026 me objekt: “Vendim lidhur me ankesën me Nr. Prot 580/2026”, drejtuar KPP-së dhe Operatorit ekonomik ankimues.

II.6.1. Referuar Vendimit të KSHA-së, Autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës.

II.7. Në përputhje me **nenin 113** të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, referuar dosjes administrative konstatohet se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuar në lidhje me ankesën.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik ANBIM ShPK dhe BESIM KAMBERI P.F, në procedurën e prokurimit sipërcituar, me pretendimet si vijon:

[...]Ofertat e dorëzuara të shoqërive ANBIM ShPK dhe BESIM KAMBERI P.F, pas vlerësimit të tyre duhet të ishin skualifikuara nga KVO- e autoritetit kontraktor si oferta anomalisht të ulëta, në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku qartësisht është përcaktuar: “5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

III.1.1. Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka vendosur pranimin e ankesës.

[...]KSHA pasi u njoh me ankesën e drejtuar nga operatori ekonomik dhe pas shqyrtimit të të gjitha dokumentacionit të administruar në dosjen e tenderi për këtë procedurë po paraqitim konstatimet në lidhje me pretendimet e ngritura, argumenton:

Në këtë procedurë prokurimi, nga 10 (dhjetë) ofertues që kanë paraqitur ofertat e tyre, vetëm njëri prej tyre është skualifikuar nga KVO-ja, konkretisht ofertuesi “I&V Company” SHPK, ndërsa 9 (nëntë) ofertuesit e tjerë janë vlerësuar të kualifikuar nga KVO-ja. Në përfundim, kemi 9 (nëntë) ofertues të kualifikuar, pasi plotësojnë kriteret për kualifikim të përcaktuara në DT, dhe si rrjedhojë kanë rezultuar më shumë se 2 (dy) oferta të kualifikuara.

Referuar rregullave të prokurimit publik, konkretisht pikës 4 të nenit 82 (Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave) të VKM nr. 285/2021, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për të verifikuar nëse ofertat e kualifikuara janë ose jo me çmim anomalisht të ulët, në rastin konkret kur kemi 9 oferta të kualifikuara, vepohet sipas rastit të dytë të kësaj pike, konkretisht si më poshtë:

“Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.”

Nga llogaritja e 85% të mesatares së ofertave të vlefshme kemi:
Oferta Anomalisht e ulët = $(2,748,768.00 + 2,903,085.00 + 3,100,375.00 + 3,182,218.00 + 3,237,698.00 + 3,598,910.00 + 3,900,060.00 + 4,700,000.00 + 5,200,000.00) / 9 \times 0.85$
= 3,059,160.77 lekë.

Oferta anormalisht e ulët rezulton nën vlerën 3,059,160.77 lekë dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, duhet të skualifikohet menjëherë pa kërkuar shpjegime, për shkak se procedura e prokurimit është me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë.

Në rastin konkret, oferta e paraqitur nga ofertuesi "ANBIM" SHPK, me vlerë 2,748,768 lekë pa TVSH, si dhe oferta e paraqitur nga ofertuesi "BESIM KAMBERI" PF, me vlerë 2,903,085 lekë pa TVSH, janë nën pragun e lejuar, pra nën vlerën 3,059,160.77 lekë pa TVSH. Si të tilla, këto dy oferta duhet të ishin skualifikuar nga KVO-ja.

Oferta që duhej të ishte renditur e para dhe fituese është oferta e shoqërisë EURO MEGA 2010 ShPK me vlerë 3.100.375 L. pa Tvsh sipas formule se zbatuar.

KSHA vlereson të gabuar vendimin e KVO-se mbi kualifikimin e operatoreve ekonomike ANBIM ShPK dhe BESIM KAMBERI P.F, vlerat e ofertave të tyre janë me të uleta se 3.059.160,77 L pa Tvsh.

Përsa me sipër KSHA vendos se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues pranohet.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse

operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Pra sa më sipër konstatohet, se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues *EURO MEGA 2010 ShPK*, për shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë *ANBIM ShPK dhe BESIM KAMBERI P.F.*, në procedurën e prokurimit sipërcituar, duke përmbushur qëllimin e ankimuesit.

Komisioni në mbështetje të neneve 30, 115, pika 1 dhe 3 dhe 118 dhe të ligjit nr. 162/2020, *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, do të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues *EURO MEGA 2010 ShPK* për procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”* Mallra, me Nr. REF-74201-01-20-2026, me objekt *“Blerje materiale pastrimi, detergjent”* me fond limit 5.083.320 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115, pika 1 dhe 3 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik *EURO MEGA 2010 ShPK* për procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”* Mallra, me Nr. REF-74201-01-20-2026, me objekt *“Blerje materiale pastrimi, detergjent”* me fond limit 5.083.320 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat duke skualifikuar operatorët ekonomikë *ANBIM ShPK dhe BESIM KAMBERI P.F.*, sipas vendimmarrjes së KSHA-së.

3. Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP-në mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me Vendimin e KSHA-se dhe konstatimet e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik EURO MEGA 2010 ShPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

